



# Partia Demokratike e Shqipërisë

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË  
KRYESIA E PARTISË

VENDIM  
NR. 165, DATË 17.12.2021

## PËR PROPOZIMIN E NJË SHTESE NË STATUTIN E PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 45 dhe 60 të Statutit të PDSH, pas diskutimit dhe vendimmarrjes së Kryesisë për propozimin e disa ndryshimeve në Statutin e PDSH, në mbledhjen e datës 17 Dhjetor 2021, Kryesia e Partisë,

Vendosi:

I. Propozimin e një shtese në Statutin e PDSH, sipas tekstit bashkëlidhur të hartuar nga Komisioni i Përhershëm i Statutit.

II. Propozimi publikohet në rubrikën e posaçme të materialeve të Kuvendit në faqen zyrtare të Partisë Demokratike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM  
GAZMENT BARDHI



KRYETARI  
LULZIM BASHA



# Partia Demokratike e Shqipërisë

## PËR NJË SHITESË NË STATUTIN E PARTISË DEMOKRATIKE

Në mbështetje të nenit 60 të Statutit, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike, në mbledhjen e datës 18 Dhjetor 2021,

### VENDOSI:

Në Statutin e Partisë Demokratike, pas nenit 58, shtohet neni 58/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me përmbajtjen si vijon

#### Neni 58/1

#### Aleanca Qytetare për Demokracinë

1. Përveç organizatave partnere të nenit 58, të tillë partia ka edhe Aleancën Qytetare për Demokracinë.
2. Kjo organizatë partnere përbëhet nga intelektualë me reputacion profesional dhe/ose kontribut të spikatur në shoqëri, të cilët shfaqin interes dhe bashkëmdajnë vlerat dhe parimet e Partisë Demokratike. Anëtarësimi në parti nuk është kusht për pjesëmarrje në Aleancën Qytetare për Demokracinë.
3. Aleanca Qytetare për Demokracinë synon të analizojë dhe të japë mendim kritik, me sugjerime konkrete dhe konstruktive, ndaj politikave, qasjeve dhe nismave zyrtare të PD-së, duke e ndihmuar partinë të forcojë dialogin, lidhjen dhe debatin konstruktiv me shoqërinë.
4. PDSH-ja garanton përfaqësimin e Aleancës Qytetare për Demokracinë me të paktën 10 për qind të të zgjedhurve në pozicionet vendimmarrëse/drejtuese të PD-së.

#### Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.